



Prishtinë, 15.08.2008
Kodi i ZRRE-së: D_114_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Neneve 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e Nenit 24 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit, të datës 30 maj 2008, **në seancën e mbajtur më 15 gusht 2008 nxori këtë:**

VENDIM

- I. **I lejohet** KOSTT SH.A-së derogimi në zbatimin e **Nenit 24 “Obligimi i Sigurimit”** të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit.
1. KOSTT SH.A në shkresën e datës 30.05.2008 ka kërkuar nga ZRRE ri-shtyrje afati të Nenit 24 të OST deri në krijimin e mundësive për të përmbushur këtë obligim, me arsyetim: duke marrë parasysh se edhe më tutje ekziston vështirësia e gjetjes së një kompanie sigurimi, e aftë për të siguruar asetet me vlerë të lartë monetare, si dhe për shkak se në aplikacionin për tarifa nuk janë planifikuar këto shpenzime.
 2. Të gjitha dispozitat tjera të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit do të mbesin në fuqi.
 3. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
 4. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
 5. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit të tij ose në datën e publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, kryesues

Nysret Avdiu, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare